



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR
KOMISIONI I ZHVILLIMIT TË KARRIERËS

OPINION

MBI

**KANDIDATEN ZNJ. {...}, E CILA KA APLIKUAR PËR T’U KOMANDUAR SI
NDIHMËSMAGJISTRATE PRANË GJYKATËS SË LARTË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në shkronjën “ë”, pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në shkronjën “a”, pika 2, të nenit 61, në shkronjën “d” të nenit 86, në shkronjën “b”, pika 1, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenet 53, 54, 56, 57 dhe 58, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe pikën 4, të nenit 34, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, mbi kërkesën e Gjykatës së Lartë, sipas Shkresës nr. 1607 prot., datë 17.07.2020 dhe shkresës nr. 1607/1 prot., datë 20.07.2020, me vendimin nr. 258 datë 23.07.2020 ka vendosur:

- 1. Hapjen e procedurës së komandimit të gjyqtarit në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë.*
- 2. Shpalljen e kërkesës për kandidatura, nga radhët e gjyqtarëve, për komandim në Gjykatën e Lartë, për pesë pozicione të lira si “ndihmësmagjistrat”.*
-*
- 3. Afati i paraqitjes së kërkesës për komandim është deri më datë 04.09.2020.*

Brenda afatit të paraqitjes së kërkesave për komandim, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor ka paraqitur kërkesë znj. Enisa Shahini, gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë.

Në nenin 54, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, lidhur me procedurën e komandimit, ndër të tjera parashikohet se: “Këshilli, brenda dy javëve pas afatit të aplikimit, përgatit një opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ose prokurorisë ku kandidati ushtron funksionin. Opinioni për çdo kandidat publikohet në faqen zyrtare të Këshillit. Kandidati, komandimi i të cilit nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ose prokurorisë, përjashtohet nga komandimi. Këshilli, brenda dy javëve pas afatit të komandimit, i dërgon institucionit në të cilin do të bëhet komandimi emrat e kandidatëve që plotësojnë kriteret e pozicionit përkatës...”

Në respektim të këtij parashikimi ligjor, lidhur me vlerësimin e Këshillit, bazuar në pikën 11 të vendimit nr. 258 datë 23.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor lidhur me procedurën e komandimit, ndër të tjera parashikohet se: *”Brenda dy javëve pas përfundimit të afatit të kandidimit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin. Projekt-opinionin për çdo kandidat shqyrtohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor jo më vonë se një javë pas njoftimit të Kryetarit të Këshillit për përgatitjen e tyre. Opinionet e miratuara nga Këshilli publikohen në faqen zyrtare të tij. Këshilli vendos përjashtimin e kandidatit nga komandimi kur komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku ai ushtron funksionin ose kur verifikohet që kandidati nuk plotëson ndonjë prej kushteve të tjera të komandimit”*

Në respektim të këtij parashikimi ligjor, lidhur me vlerësimin e Këshillit, nëse komandimi është në përputhje me interesat e larta të gjykatës ku kandidatja ushtron funksionin, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës çmon se, në rastin konkret, komandimi i kësaj gjyqtareje nuk vjen ndesh me interesat e larta të gjykatës ku ajo ushtron funksionin, duke iu referuar organikës së kësaj gjykate dhe numrit të çështjeve që janë në gjykim.

Nga informacioni i marrë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, si dhe nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë rezultoi se : *“Kjo gjykatë ka në organikë 4 (katër) gjyqtarë. Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë prej datës 1 janar 2020 deri në datën 1 shtator 2020 janë regjistruar 944 çështje gjyqësore, së bashku me çështjet e mbartura. Janë gjykuar 758 çështje dhe aktualisht deri sot më datë 1 shtator 2020 janë në gjykim 186 çështje gjyqësore. **Gjyqtarës {...}prej datës 1 janar 2020 deri në datën 1 shtator 2020 i kanë kaluar përmes shortit 153 çështje gjyqësore. Ka gjykuar 121 çështje dhe aktualisht deri më datë 1 shtator 2020 ka në proces gjykimi 32 çështje gjyqësore. Gjyqtari {...} prej datës 1 janar 2020 deri në datën 1 shtator 2020 i kanë kaluar përmes shortit 241 çështje gjyqësore. Të mbartura nga viti i mëparshëm ka patur 60 çështje gjyqësore. Ka gjykuar 247 çështje dhe aktualisht deri më datë 1 shtator 2020 ka në proces gjykimi 54 çështje gjyqësore. Gjyqtarja {...}prej datës 1 janar 2020 deri në datën 1 shtator 2020 i kanë kaluar përmes shortit 238 çështje gjyqësore. Të mbartura nga viti i mëparshëm ka patur 98 çështje gjyqësore. Ka gjykuar 269 çështje dhe aktualisht deri më datë 1 shtator 2020 ka në proces gjykimi 67 çështje gjyqësore. Gjyqtari {...} prej datës 1 janar 2020 deri në datën 1 shtator 2020 i kanë kaluar përmes shortit 153 çështje gjyqësore. Të mbartura nga viti i mëparshëm nuk ka patur çështje gjyqësore. Ka gjykuar 120 çështje dhe aktualisht deri më datë 1 shtator 2020 ka në proces gjykimi 33 çështje gjyqësore”***.

Përveçse sa më lart, Komisioni vlerëson se komandimi nuk cenon funksionalitetin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, ku gjyqtarja ushtron detyrën, bazuar dhe në përgjigjen e përcjellë nga Kryetari i kësaj gjykate pas kërkesës së Këshillit për të dhënë opinionin e tij, ku rezultoi

se : “Në përgjigje të kërkesës për informacion plotësues të kërkuar nga ju, shpreh opinionim tim se komandimi i Gjyqtarës{...} në Gjykatën e Lartë, aktualisht nuk pengon funksionalitetin e Gjykatës Administrative Shkalla e Parë Korçë. Kjo gjykatë aktualisht ka 4 gjyqtarë dhe mund të funksionojë edhe me tre gjyqtarë për të përballuar ngarkesën aktuale në punë. Aktualisht ka rreth 1 vit që ngarkesa në punë e gjyqtarëve të kësaj gjykate është në rënie. Këtë e tregon numri i çështjeve të regjistruara nga data 1 Janar 2020 e deri më sot si dhe ngarkesa e çdo gjyqtari të kësaj gjykate aktualisht...”

Në këto kushte, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson se komandimi i znj. {...} në pozicionin e Ndihmës Magjistratit në Gjykatën e Lartë, nuk passjell cenim të interesave të larta të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë për sa kohë nuk cenohet funksionaliteti i saj, ndërsa kjo gjykatë, në rrethanat aktuale ka mjaftueshëm gjyqtarë për ofrimin e shërbimit gjyqësor.

Bazuar sa më sipër, me qëllim për të vijuar me procedurat e mëtejshme të komandimit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor:

- *Miratimin e opinionit për kandidaten, gjyqtaren{...}.*
- *Publikimin e këtij opinionit në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

KOMISIONI I ZHVILLIMIT TË KARRIERËS